

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, në mungesë të shefit të komisariatit, grupi i punës u takua me shefin e rendit të Komisariatit të Policisë Pukë, z. Haki Sula, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, shefi i rendit informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë së këtij komisariati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, i shoqëruar nga shefi i rendit, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të komisariatit, ambientet ndihmëse të tij, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, si dhe kqyri e kontrolloi plotësimin sipas rubrikave të regjistrit ku evidentohen të dhënat e personave të shoqëruar/të ndaluar apo të arrestuar, librin e kërkesë/ankesave, regjistrin për të miturit në konflikt me ligjin, plotësimin e modelit të formularit të shoqërimit dhe ruajtjen dhe administrimin e kopjeve të procesverbaleve të shoqërimit.

Gjithashtu, z. Sula angazhoi edhe punonjësit e policisë së ambienteve të shoqërimit të këtij institucioni që të ishin prezent për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer në vijim të procesit të inspektimit. Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësën përgjegjëse të dhomave të shoqërimit, që na u bashkua gjatë evidentimit të kushteve të ambienteve të Komisariatit të Policisë Pukë.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin e mëparshëm, krahasuar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe aktet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Shefi i rendit dhe punonjësit e Komisariatit të Policisë Pukë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë zhvillimit të inspektimit.

Në Komisaratin e Policisë Pukë, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, rezultoi se:¹

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për vendosjen në zyrën e informacionit të komisariatit të regjistrit për evidentimin e kërkesë/ankesave të të shoqëruarve².

¹ Rekomandim për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Pukë, nr. K4/23-2, prot, datë 22.07.2022

² Kthim përgjigje të shkresës tonë me numër 7119/1 prot, datë 19.08.2022 për Komisaratin e Policisë Pukë.

2. **Ishin zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për garantimin e kushteve higjieno-sanitare në ambientet e Komisarariatit të Policisë, por kishte nevojë për lysterje të dhomës së shoqërimit.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për nxitjen dhe vënien në zbatim të projektit të propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Pukë, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Pukë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit, si dhe në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Pukë.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për organizimin e trajnimeve me stafin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit, për plotësimin e regjistrit të të shoqëruarve sipas të gjitha rubrikave, evidentimin e të dhënave të sakta të tyre mbi arsyen e shoqërimit, orën e shoqërimit të personave në mjediset e policisë së shtetit, orën e lënies së lirë të tyre, si dhe të rubrikës për njoftimin e familjarëve me emrat, lidhjen familjare me të shoqëruarin dhe telefonat e tyre, sipas përcaktimeve në procedurën standarde dhe rekomandimeve CPT-së për këtë qëllim.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Pukë.

Kërkesat e bëra nga Komisarati i Policisë Pukë drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër për vitin 2023 kishin të bënin vetëm me regjistrat për Seksionin e Rendit në Komisarariatit të Policisë Pukë . Avokati i Popullit vlerëson se drejtuesit kanë pasur kohë të mjaftueshme për të bërë kërkesat buxhetore për të përmirësuar situatën të paktën për disa rekomandime, por nuk e kanë bërë këtë gjë duke treguar mungesë bashkëpunimi dhe vlerësimi të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varet nga njësia vendore. Çdo komisarariat duhet të demostrojë se ka qenë konsequent në kërkimin e fondeve, dhe se ka bërë hapa konkrete për të zbatuar rekomandimet e pranuar.

Sipas informacionit, nga Drejtoria e Mbështetjes Logjistike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është bërë një studim i projektimit “Rikonstruksion/Ndërtim i objekteve të Komisarariatit të Policisë Pukë”. Ky projekt i është dërguar Komisarariatit të Policisë Pukë për vlerësimin dhe konfirmimin e situatës infrastrukturore inxhinierike. Drejtuesit e këtij institucioni pasi kanë diskutuar me detaje për ambientet, zyrat, dhomat e pritjes, shoqërimit dhe ndalimit nuk kanë patur vërejtje dhe kanë rënë dakord me projektin e paraqitur. Në vijim priten parashikimet e mëtejshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për jetësimin e këtij projekti.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisarariatit e Policisë Pukë ishin marrë pak masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, situata mbetet njëloj problematike me përjashtim të një regjistri të shtuar.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarariatit e Policisë Pukë, ambienti i shoqërimit **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentat ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Komisariati i Policisë Pukë funksiononte në një godinë të vjetër dhe të amortizuar. Ambienti i shoqërimit ishte në katin e dytë të godinës dhe përbëhej nga **1 (një) dhomë shoqërimi**, e cila ishte përshtatur brenda ambienteve të godinës së institucionit dhe nuk ishte ndërtuar sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit³. Ajo përdorej për meshkujt madhorë, ndërkohë **që nuk kishte dhomë për shoqërimin e grave dhe të miturve**.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për gratë dhe të miturit⁴ në konflikt me ligjin është një problem thelbësor që paraqitet në këtë komisarariat, duke mos siguruar garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

³ “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Konkretisht nuk plotësoheshin parametrat tërësore të parashtruar nga procedura standarde.

⁴ *Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se: “Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gra, meshkujt madhorë dhe të miturit”.*

Për shoqërimin e grave dhe të miturve përdorej ambienti i pritjes në hyrje të këtij komisariati ose personat qëndronin në një ambient të hapur në oborrin e jashtëm të institucionit në mungesë të dhomave të përshtatshme.

Dhoma e shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, e pajisur me stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave, por mungonte tavolina për të qenë një ambient sa më kreativ. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona.

Dhoma e shoqërimit kishte dritare përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dera ishte prej druri, me mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi dhoma ishte e pastër nga ana higjieno-sanitare, por kishte nevojë për lyerje dhe dezinfektim në mënyrë herë pas hershme. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, i pajisur me çezmë dhe kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Tualeti nuk plotësonte kushtet higjieno-sanitare, dhe kishte nevojë për larje, lyerje dhe dezinfektim të herë pas hershëm të tij. Në ambientet e këtij komisariati mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*⁵.

Në këtë komisarjat, ende nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të këtij institucioni, një konstatim i cili është i përsëritur edhe nga inspektimi i mëparshëm. Në kushtet e vendodhjes së komisarjatis, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është e domosdoshme instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme dhe të jashtme të tij.

Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të komisarjatis, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit tonë, si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarjatis, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe

⁵ Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* ku përcaktohet se: *“Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim”*.

mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në Komisarlatin e Policisë Pukë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 24.10.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **57** persona, ku të 57 personat ishin shtetas madhorë të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** të shoqëruar në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia informoheshin për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke iu siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarlat, për të garantuar njohuritë e të shoqëruarve për të drejtat e tyre.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar, si dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2023 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Në Komisarlatin e Policisë Pukë mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale, në mungesë të saj oficerët e policisë gjyqësore, sendet të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre të cilat shërbejnë edhe për intervistimin e personave të shoqëruar/ndaluar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ndonjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit. Gjatë inspektimit u kqyrën në 2 zyrat e oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e komisarlatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave mund të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Pukë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Shkodër.

Regjistri i personave të shoqëruar, të ndaluar/ të arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisarlatin e Policisë Pukë “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e regjistrit për personat e shoqëruar rezultoi se ai ishte i sekretuar, por **nuk** ishte i plotësuar sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në procedurën standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”⁶. Konkretisht, në rubrikën për njoftimin e familjes **mungonte** emri i personit të njoftuar, lidhja me të shoqëruarin, si dhe numri i telefonit të familjarëve. Në disa nga rastet e tjera të shoqërimit, në regjistër **mungonte** edhe përshkrimi i arsyeve të shoqërimit, ora e shoqërimit të personave dhe ora e lënies së lirë. Kjo praktikë, përbën shkelje të standardeve dhe mos kryerje të detyrës nga punonjësit e policisë, që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit të këtij komisarati. Njëkohësisht, këto shkelje çojnë në dyshime të arsyeshme se, një pjesë e shënimeve mund të jetë fiktive, përse nuk ka të dhëna në lidhje me identifikimin e familjarëve.

Ndërkohë, kjo është gjetja e përsëritur ndaj vlerësojmë se ka arsye të besohet se ky veprim është rezultat i plotësimit fiktiv të regjistrave dhe jo çështje padijenie, ndaj kërkojmë që zbatimi i ketyre procedurave të verifikohet edhe më tej nga Drejtori i Policisë së Qarkut Shkodër.

Koha e qëndrimit të shtetasve në ambientin e shoqërimit ishte e ndryshme nga 1 orë deri 4 orë, por jo më shumë se 10 orë. Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryhet nga oficeri/agjenti i Policisë Gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295/2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit nën hetim ishte brenda 12 orëve.

Në këtë komisarati kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarati kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që u krye inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë. Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa nëse kishin të tilla.

Gjithashtu, në këtë komisarati administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin, ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2023 **nuk** kishte të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe në disa gjuhë të huaja.

Ambientet e intervistimit

⁶ Kreu VII, i procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Në Komisarariat e Policisë Pukë oficerët e Policisë Gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra **nuk ishin të monitoruara** dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore⁷.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Komisariati i Policisë Pukë në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues tek fëmijët.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Nga komunikimi me punonjësit e policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë informuan grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Pukës. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Pukë ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Pukë, për të marrë ndihmën mjekësore.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë

⁷ Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu, kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme, ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse, një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorët e godinës dhe në dhomën e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/të arrestuar. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për nxitjen dhe vënien në zbatim të projektit të propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisaritit të Policisë Pukë, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjtoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit, si dhe në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisariatin e Policisë Pukë.
4. Marrjen e masave disiplinore dhe verifikimin nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër në vazhdimësi për mundësi plotësimi fiktiv të regjistrave.
5. Marrjen e masave për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

6. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit⁸.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe për meshkuj, si dhe pajisjen e tyre me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Pukë.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
10. Marrjen e masave të nevojshme, për mirëmbajtjen dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare në ambientet e Komisarariatit të Policisë, si dhe lyerjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI

⁸ Kreu VI, pika 4/i1 e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.